



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.02.2025

Nr: 139

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN NR. 27 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË DEMOKRATIKE/PD

Sot më datë 22.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Agron Malaj**
Kryetar për Bashkinë Mat

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara sipas vendimit nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator nëpërmjet shpalljes së njoftimit “Ftesë për ofertë” për shërbim publikimi dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale.

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 27 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Këshilli i Bashkisë Mat ka shpallur procedurat e prokurimit për shërbim publik dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale

Data: 22.02.2025

Nr: 139
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 27 ID datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

para fushatës zgjedhor. Në portale mediatike të ndryshme është publikuar njoftimi “Ftesë për ofertë” me këto të dhëna:

- Autoriteti/enti kontraktor: *Bashkia Mat;*
- Objekti i kontratës: *shërbim publik dhe pasqyrimi i veprimtarive të Bashkisë Mat në media lokale;*
- Kohëzgjatja e kontratës: *12 muaj;*
- Data e zhvillimit: *12.02.2025, ora 15:00;”*

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Agron Malaj, Kryetar për Bashkinë Mat.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI